



REPULIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI



KOMUNA E PRIZRENIT
OPËTINA PRIZREN
PRIZREN BELEDIYESI

➤ Masa 15

PAKOJA
FISKALE
EMERGJENTE

Prill-Qershor 2020

➤ FAMILJET QË PËRFITOJNË:

Familjet të cilat nuk e kanë asnjë të punësuar (sektorin publik dhe privat)

- Familjet që nuk pranojnë asnjë pagesë mujore nga Buxheti i Republikës së Kosovës (pension apo asistencë tjetër sociale)
- Aplikanti është i lajmëruar si i papunë në institucionin kompetent dhe
- Aplikanti është banor rezident në Republikën e Kosovës.

VETËM NJË PËRFAQËSUES I FAMILJES DEKLAROHET SI PËRFITUES I SKEMËS! PËR KËTË ARSYE NUK DUHET TË APLIKOJNË TË GJITHË ANËTARËT, POR VETËM NJË ANËTAR, DUKE I SHËNUAR TË DHËNAT E TË GJITHË ANËTARËVE TË TJERË TË FAMILJES ME TË CILËT JETONI DHE VEPRONI BRENDË NJË KULMI TË SHTËPISË APO BANESËS!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI



KOMUNA E PRIZRENIT
OPËTINA PRIZREN
PRIZREN BELEDIYESI

➤ Masa 15

PAKOJA
FISKALE
EMERGJENTE

Prill-Qershor 2020

➤ Parakushtet për aplikim janë:

- Parakusht i parë për të përfituar familja asistencën mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë euro (130), është që aplikuesi dhe të gjithë anëtarët me të cilët jeton në bashkësi familjare duhet të jenë të papunësuar. Edhe nëse aplikoni, nuk mund të përfitoni!
- Parakusht i dytë është që asnjëri nga anëtarët e familjes nuk duhet të jetë pjesë e përfitimit nga cilado prej skemave sociale dhe pensionale të financuara nga Buxheti i Shtetit. (Edhe nëse aplikoni, nuk mund të përfitoni).
- Parakushti tretë është që parashtruesi i kërkesës (aplikanti) duhet të jetë i regjistruar në Zyrat e Punësimit dhe të ketë statusin e të papunësuarit. Për qytetarët të cilët kanë qenë të regjistruar të papunë dhe kanë deklaratë të papunësisë një gjë e tillë nuk ka nevojë të përseritet, ndërsa ata të cilët nuk janë të regjistruar duhet të regjistrohen dhe këtë mund ta bëjnë duke u regjistruar në **platformën online** (<https://aprk.rks-gov.net/sq-AL/Account/RegisterJobSeeker?fbclid=IwAR2xhzvuKI8CcB0pysuTrFsosPrrpUI7UyZ ZOP0Xg4MSKHK7500IRSvOjPw>) të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës apo duke aplikuar drejtpërdrejt në Zyrën e Punësimit. (Aplikacioni juaj nuk do të mund të shqyrtohet dhe aprovohet pa u plotësuar edhe ky parakusht).



REPULIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI



KOMUNA E PRIZRENIT
OPËTINA PRIZREN
PRIZREN BELEDIYESI



Masa 15

PAKOJA
FISKALE
EMERGJENTE

Prill-Qershor 2020



METODA DHE AFATET E APLIKIMIT

-Nëse keni plotësuar tre parakushtet për aplikim të përshkruara më lartë mund të aplikoni për të përfituar nga Masa nr.15 duke përzgjedhur njëri prej metodës dhe mënyrës së aplikimi:

a) Aplikimi Online - duke përdorur formularin elektronik. Ju mund të shkarkoni formularin e duhur nga faqja <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/315CF2CC-9C7C-4424-ACCA-323E3C973C69.pdf>. Formulari duhet të plotësohet dhe dërgohet në e-mail adresën zyrtare pako15@rks-gov.net, duke bashkangjitur ne e-mail të skanuar (apo fotografuar) kopjen e letërnjoftimit dhe Kjo është mënyra e rekomanduar pasur parasysh situatën e pandemisë dhe emergjencës shëndetësore.

b) Aplikimi Fizik - aplikimi mund të bëhet përmes Qendrës për Punë Sociale të Komunës së Prizrenit, duke marrë Formën e aplikacionit tek Zyrtari i Ndihmës Sociale dhe pasi që të keni plotësuar dhe nënshkruar formën e aplikacionit së bashku me kopjen e letërnjoftimit të parashtruesit të kërkesës duhet të dorëzoni në Qendrën për Punë Sociale tek Zyrtari i Ndihmës Sociale.

Aplikimi në njëri prej metodave të lartshënuara mund ta bëni më së largu deri me 15 Maj 2020.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI



KOMUNA E PRIZRENIT
OPËTINA PRIZREN
PRIZREN BELEDIYESI



Masa 15

PAKOJA
FISKALE
EMERGJENTE

Prill-Qershor 2020



PLOTËSIMI I FORMËS SË KËRKESËS/APLIKACIONIT

Pasi të keni përzgjedhur njërën nga metodat e aplikimit regjistrimin online apo aplikimin fizik duhet t'i kushtoni vëmendje plotësimi të Formës së aplikacionit, i cili ka katër (4) pjesë;

a) Të dhënat e përgjithshme- në këtë pjesë duhet të përfshihen të dhënat e komunës ku jetoni, vendbanimi (emri qytetit apo fshatit), adresa, nacionaliteti, gjuha që flisni, telefoni dhe email. Të gjitha të dhënat në këtë pjesë janë obligative të plotësohen duke përfshirë email-in e juaj nëse jeni duke aplikuar online përmes formularit elektronik.

b) Të dhënat e parashtruesit të kërkesës- në këtë pjesë duhet të përfshihen të dhënat e numrit personal të letërnjoftimit, emri dhe mbiemri i aplikuesit dhe deklarimi nëse jetoni në bashkësi familjare. Bashkësi familjare nënkupton familja e ngushtë dhe të gjithë anëtarët të tjerë të familjes me të cilët jetoni dhe veproni brenda një kulmi të shtëpisë apo banesës.

c) Të dhënat e anëtarëve të familjes- në kuadër të kësaj pjesë duhet të përfshihen të dhënat e të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare me të cilët jetoni, duke regjistruar të dhënat e numrit të letërnjoftimit, emrin dhe mbiemrin për çdo njërin anëtarë të bashkësisë familjare dhe afërsinë familjare që keni ju si parashtrues i kërkesës.

Të gjitha të dhënat e parashtruesit të kërkesës dhe anëtarëve të familjes të regjistruara në kuadër të formës së aplikacionit duhet të janë të vërteta dhe pasi të keni plotësuar këtë formë të aplikacionit, ju duhet të nënshkruani dhe vendosni datën e aplikimit. Nënshkrimi në formën elektronike bëhet duke vendosur emrin dhe mbiemrin tuaj në rubrikën e caktuar në formën e elektronike.